



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:143424  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05609086

**PAKR.nr.705/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Ferit Osmani, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Shabani Krasniqi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.I., nga fshati ....., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.254/2022, të dt.14.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.17.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.254/2022, të dt.14.06.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.254/2022, të dt.14.06.2023, është liruar nga akuza në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, i akuzuari I.I., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 të KPK, pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Shpenzimet procedurale penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.641/2023, të datës 13.12.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.254/2022, të dt.14.06.2023, të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi në proporcion me veprën e kryer penale, ose që i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji ka caktuar seancën e kolegjit për datën 17.04.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari I.I., dhe mbrojtësi i tij, av.Illir Shaqiri, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, edhe pse ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akzuarit I.I., av.Illir Shaqiri, ka deklaruar se sa i përket kësaj çështje penale, aktgjykimi duhet të vërtetohet, kurse sa i përket ankesës së ushtruar nga ana e prokurorisë, e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

I akuzuari I.I., ka deklaruar se e mbështet ankesën e paraqitur nga mbrojtësi i tij.

Gjykata e Apelit, në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, nuk është e bazuar**

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 nën par.2.7 të KPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pa kuptueshëm, është në kundërtënie me gjendjen faktike apo faktet vendimtare të cilat janë prezantuar në arsyetim të aktgjykimit. Sa i përket pa qartësisë së aktgjykimit e njëjta ekziston në atë se provat e proceduara gjatë të gjitha seancave gjyqësore dhe të prezantuara në arsyetim të aktgjykimit nuk kanë refleksione në dispozitivin e aktgjykimit, e po ashtu aktgjykimi ka edhe shkelje të tjera, për të cilat Gjykata e Apelit duhet të përkujdeset sipas detyrës zyrtare.

Kolegji i kësaj gjykata ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me pretendimet sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë të tjera të aktgjykimit, sikurse është arsyetimi, sepse nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye lidhur me mos ekzistimin e fakteve vendimtare të cilat karakterizojnë mos ekzistimin e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 të KPK. Gjykata e shkallës së parë është përkujdesur në mënyrë të drejtë dhe të qartë të zbatimit të dispozitave përkatëse ligjore, e posaçërisht është përkujdesur që aktgjykimi mos të përfshihet në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, e cila duhet të jetë në harmoni edhe me pjesë të tjera, që janë me rëndësi për vërtetimin e ekzistimit apo mos ekzistimit të veprës penale. Nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë, se cilat fakte janë të paraqitura sikurse të vërtetuara apo të pa vërtetuara, që nënkupton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka vlerësuar saktësinë e të gjitha provave nga shkresat e lëndës, si dhe ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për çdo propozim të ngritur për vendosjen e çështjes penale, si dhe meritave për zgjedhjen e çështjes penale. Nga të gjitha vlerësimet të cilat i ka bërë gjykata e shkallës së parë, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk janë vërtetuar elementet inkriminuese të kryera nga ana e të akuzuarit, përkitazi me veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj edhe është nxjerr aktgjykim lirues.

Po ashtu nga ankesa e prokurorisë, rezulton se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk është vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë gjendja faktike, ngase rezulton se në këtë çështje penale është bërë vlerësim arbitrar dhe në kundërshtim me çmuarjen e lirë të provave, përkundër asaj që obligimi i gjykatës është që ti vlerësoj të gjitha provat nga shkresat e lëndës, për të vërtetuar ekzistimin apo mos ekzistimin e veprës penale. Fare mirë dihet që parimi i çmuarjes së lirë të provave, nënkupton që pas përfundimit të procedurës së provave, prezantimit të provave, vlerësohet fuqia provuese e provave të shqyrtuara, dhe arsyetohet qëndrimi i gjykatës përkitazi me vlerësimin e të njëjtëve. Që të gjitha këto nuk janë respektuar, ashtu që edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet e pretenduara, pasi që gabimisht është vërtetuar gjendja faktike.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar se aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe ka ardhur në përfundim se nga ankesa e prokurorisë, nuk qëndrojnë pretendimet përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe rezulton se e njëjta është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, që derivon nga provat materiale dhe personale në shkresat e lëndës. Se gjykata e shkallës së parë, ka proceduar me të gjitha provat, pasi që ka nxjerrë aktgjykim lirues, vihet në përfundim nga provat materiale, sikurse është raporti i oficerit të policisë së Kosovës, testi fushor mbi llojin e substancës narkotike, vërtetimi mbi konfiskimin e substancës narkotike, foto dokumentacionin nga shkresat e lëndës dhe deklarimi i dëshmitarit G.M., si dhe deklarata e të akuzuarit. Kjo para se gjithash nga vlerësimi i deklaratës së dëshmitarit G.M., e dhënë me dt.13.04.2023, i cili ka deklaruar se e njeh fare pak të akuzuarin, me të cilin ka ndenjtur katër, pesë herë dhe kanë pi nga një kafe, dhe ka ndodhur që nga i njëjti ka ble dy, tri herë drogë, dhe atë 2-3 gjojt, me sa i kujtohet 5 ose 10Euro, ashtu që asnjëherë nuk ka pasur marrëveshje me I., dhe

thekson se nuk i kujtohet dhe nuk dinë çka ka deklaruar, por kur e kanë arrestuar zyrtarët policor në fshatin Hodonoc, dhe e kanë sjellë në stacionin policor në Gjilan, thekson se nuk e kam njohur I., dhe se deklarata e tij nuk paraqet qëndrueshmëri, ashtu që ka qenë e pa besueshme. Po ashtu edhe nga të gjitha provat materiale nuk mund të vihet në përfundim se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 të KPK. Pasi që kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar ka ardhur në përfundim se deklarata e dëshmitarit G.M., nuk kanë qenë konsistente dhe nuk kanë paraqitur kredibilitet për të vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, për të cilën janë akuzuar, andaj pasi që nuk ka provuar se ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar, në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, e ka liruar nga akuza.

Përkundër asaj që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, së bashku me të gjitha shkresat e lëndës dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara nga ana e prokurorisë, ashtu që pasi që nuk kemi shkelje të ligjit penal, të paraparë në nenin 385 të KPPK, kolegji ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza, sepse ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga ndjekja penale dhe përgjegjësia penale, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, dhe se e njëjta ka qenë e paraparë në ligjin e aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, andaj gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.705/2023, të datës 23.04.2024**

**Procesmbajtëse,**  
**Valbona Shabani Krasniqi**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Zyhdi Haziri**

**Ferit Osmani**